

Matteo Re

Editor

**I CONGRESO INTERNACIONAL HISPANO-ALBANÉS: ÁMBITO
FILOLÓGICO INTERNACIONAL, HISTORIA Y CULTURA
ESPAÑOLA CONTEMPORÁNEA**

Actas

2-3 de abril de 2012

UNIVERSIDAD DE TIRANA

III edición corregida

Mayo de 2014



Universidad
Rey Juan Carlos

 **Santander**
UNIVERSIDADES

 **Universidad
Rey Juan Carlos**
Vicerrectorado de investigación
Cátedra Presdela
Presencia Española y Desarrollo Socioeconómico en Iberoamérica

Comité Científico: José Manuel Azcona, Matteo Re, Juan Francisco Torregrosa, Klodeta Dibra, Artur Sula, Esmeralda Kromidha, Isabel Leal, Eugenio García.

Coordinador Académico: José Manuel Azcona.

ISBN: 978-84-615-8145-0

© El editor/ Los autores, 2012

© Universidad Rey Juan Carlos, 2012

Queda prohibida, salvo excepción prevista en la ley, cualquier forma de reproducción, distribución, comunicación pública y transformación de esta obra sin contar con la autorización de los titulares de propiedad intelectual.

ÍNDICE

METODOLOGÍA DE LAS MIGRACIONES INTERNACIONALES

ESCUELAS Y MÉTODO EN LOS PROCESOS MIGRATORIOS INTERNACIONALES	6
José Manuel Azcona	

COMUNICACIÓN CULTURAL EN ESPAÑOL

LA COMUNICACIÓN Y LA CULTURA EN EL ESCENARIO DE IBEROAMÉRICA	17
Juan Francisco Torregrosa Carmona	
LOS TÓPICOS SOCIALES DE LOS EXTRANJEROS QUE VISITAN ESPAÑA	30
Eugenio García Pérez	
THE PRESENCE OF IBERIAN AMERICAN CINEMA IN SPAIN	51
Eugenio García Pérez	

LITERATURA HISPANOAMERICANA

LA DINÁMICA DEL COSMOS FEMENINO EN LA OBRA DE GABRIEL GARCÍA MÁRQUEZ	64
Majlinda Abdiu	
ALGUNOS RASGOS DE LA DIVERSIDAD ESTILÍSTICA EN LA PROSA MARQUESINA	79
Majlinda Abdiu	
ASPECTOS GENERALES ESTILÍSTICOS EN LA LITERATURA FEMENINA IBEROAMERICANA	95
Flavia Kaba	

LITERATURA EN ESPAÑOL EN ALBANIA

RECEPCIÓN DE LA LITERATURA EN ESPAÑOL EN ALBANIA: CUÁNDO, CÓMO, POR QUÉ ...	107
Mario García Moreno	

LITERATURA Y MÉTODO DOCENTE

THE USE OF DIFFERENT GENRES OF LITERATURE IN EFL CLASSES	118
Elvana Shtepani	
LA COMPOSANTE CULTURELLE DANS LE DÉVELOPPEMENT DE LA LITTÉRATURE EN LANGUE ÉTRANGÈRE	131
Eldina Nasufi	

MITOS IDENTITARIOS DE LA SOCIEDAD ALBANESE

IL MITO ANTICO E NUOVO DELL'ITALIA NEL TERRENO SOCIO-CULTURALE ALBANESE.....	140
Diana Kastrati	
MITI MODERN I IDENTITETIT	153
Diana Kastrati	

INTERCULTURALISMO IDOMÁTICO

ORIENTALIZMAT NË RRJEDHËN E ITALIANIZMAVE NË GJUHËN SHOIPE	178
Adriatik Derjaj Flavia Kaba	

DIDÁCTICA DE LA ENSEÑANZA EN LENGUAS MODERNAS

L'USO DELLE TIC APPLICATE ALL'INSEGNAMENTO DELL'ITALIANO COME LS. UN ESEMPIO PRATICO: IL CAMPUS VIRTUAL	189
Matteo Re	
BREVE INTRODUCCIÓN A LA COMPETENCIA SOCIOCULTURAL EN EL AULA DE E/LE EN ALBANIA	200
Aida Myrto	
EXPERIENCIAS DE AULA: WEB 2.0 EN LA CLASE DE COMUNICACIÓN TURÍSTICA	210
Isabel Leal Valladares	
LA VALUTAZIONE E L'AUTOVALUTAZIONE DELLA PERFORMANCE NELLA LINGUA C(QCE): MODALITÀ EFFICIENTI PER UN FEEDBACK CONTINUO	225
Ela Vasi	
TRADURRE LE VARIETÀ LINGUISTICHE DI UN'OPERA LETTERARIA	238
Mirela Papa Anastasi Prodani	
ACTION RESEARCH AS A MEANS OF TEACHER PROFESSIONAL DEVELOPMENT	256
Vjollca Hoxha	
CULTURE AS A CRUCIAL COMPONENT OF LANGUAGE LEARNING	264
Miranda Veliaj-Ostrosi	
THEATRICAL TRANSLATION PROBLEMS FROM SPANISH INTO ALBANIAN AND VICE-VERSA	273
Iris Klosi Esmeralda Subashi	
THE CHALLENGE YOUNG TEACHERS IN THE FIRST YEAR OF LANGUAGE TEACHING.....	286
Shpresa Delija Ymer Leksi	
DIATESI PASSIVA NELLA LINGUA GRECA	293
Eneida Mataj	
EDUCATION AU PLURILINGUISME EN CONTEXTE ALBANAIS: ENJEUX ET PERSPECTIVES .	302
Silvana Vishkurti	

INTERCULTURALISMO IDIOMÁTICO

ORIENTALIZMAT NË RRJEDHËN E ITALIANIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE

Adriatik Derjaj

Departamenti i Gjuhëve Sllavo- Ballkanike

Universiteti i Tiranës/Albania

Flavia Kaba

Departamenti i Gjuhës spanjolle

Universiteti i Tiranës/Albania

Hyrje

Prania e elementëve të një gjuhe në një gjuhë tjetër nënkupton huazimet e njërës gjuhë nga tjetra. Në parim, dukuria e huazimeve gjuhësore është fryt i *kontaktit* që folësit e njërës bashkësi gjuhësore kanë patur me folësit e një bashkësie tjetër gjuhësore. Një kontakt i tillë mund të jetë rrjedhojë e një gjerdani rrethanash dhe faktorësh, nga ata kulturorë dhe fetarë, deri tek rrethanat dhe faktorët historikë, gjeografikë, politikë, ekonomikë, socialë etj. Vështruar nga ky drejtim, natyra e kontaktit përcakton vetë *dinamikën* e huazimeve, ndërkohë që shkalla, shtrirja, kohëzgjatja dhe dendësia së tij, përcakton – së paku në parim – *tipologjinë* e tyre.

Në këtë kumtesë do të bëjmë një provë për vlerësimin e huazimeve orientale në shqipe duke bërë së pari klasifikimin tipologjik të turqizmave sipas hershmërisë dhe rrënjës apo thellësisë së depërtimit të tyre në mjediset shqiptare si dhe një shqyrtim të gjeografisë së turqizmave, arabizmave, persizmave, aramiizmave, asirianizmave në kuadrin e italianizmave në shqipe dhe në arealin ballkanik. Në këtë kuadër do të trajtohet përshtatja fonetike dhe morfologjike e huazimeve orientale në shqipen siç është problemi i theksit fundor të turqizmave dhe trajtimi i tyre i diferencuar në arealin toskë e gegë (i ashtuquajtur i kalimi i theksit nga oksiton në para oksiton; tipi káfé për kafé, tenxhére për tenxheré, bába për babá,

etj.). Së dyti do të trajtohen probleme të ashtuquajturave huazime të tërthorta të shqipes psh: Ramazan – Ramadan, asqer – asker, ottoman – osman, etj.

Në kuadrin e zhvillimeve dhe kaheve të mëtejshme të shoqërisë së sotme evropiane dhe përgjithësisht botërore, prej kohësh ka filluar, është përvijuar dhe po shkon gjithmonë e më tepër drejt një përfshirjeje tërësore, procesi i njohur me termin globalizim.

Globalizimi prek në radhë të parë fushat që janë më të afërta me politikën, si: ekonominë, marrëdhëniet publike dhe marrëdhëniet me jashtë, krejt sistemin e komunikimeve me shkrim e me gojë dhe në këtë kuadër të gjërë edhe procesin e marrëdhënieve ndërgjuhësore të cilat në qoftë se deri vonë ndiqnin kryesisht sistemin e kalimeve binare (ose të ndikimeve të ndërsjella nga një kulturë në tjetrën, përkatësisht nga një gjuhë në tjetrën), tani, krahas kësaj udhe që mbetet edhe më tej, priren të ndjekin edhe udhën e ndërkëmbimeve të shumëfishta. Është e qartë pra, se po del në plan të parë procesi i globalizimit, të cilin ndoshta për ta pasur më të qartë mund ta thoshim me një fjalë tjetër shqipe, procesi i botërorizimit, që kalon së pari nëpërmjet procesit tashmë të njohur të evropianizimit.

Nuk është detyrë e trajtimit tonë, por nuk mund të mos përmendim kalimthi këtu se zhvillimi i përgjithshëm i përparimit kulturor, letrar e gjuhësor në të gjitha epokat e njohura nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, është karakterizuar nga një farë “kampëzimi” ose thënë më qartë nga një ndarje në kampe: në kohën e hershme ndarja e kulturave të Evropës në dy hapësira të njohura Lindja dhe Perëndimi, pastaj në vijim dhe në gërshëtim me këtë ndarje ka shkuar procesi i kampëzimit sipas ndarjes fetare: së pari ndarja midis botës së krishterë dhe jo të krishterë (përkatësisht pagane), më vonë me lindjen e fesë islame bëhet një ndarje tjetër shumë e madhe midis dy qytetërimeve, atij kristian dhe atij mysliman, të cilat i ka shpjeguar gjerë dhe gjatë Samuel P. Huntington në librin e tij të famshëm “Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit të ri botëror”. Duke përmbledhur që të shkojmë drejt çështjes që na intereson, njerëzit e përcaktojnë veten nga pikëpamja e paraardhësve, besimit, gjuhës, historisë, vlerave, zakoneve dhe institucioneve. Në mendësinë e tyre çojnë peshë grupet ose bashkësitë etnokulturore, si : fiset, grupet etnike, bashkësitë fetare, kombet dhe në nivelin më të gjerë qytetërrimet.¹

Grupimet më të rëndësishme të shteteve nga një shekull në tjetrin, nga një epokë në tjetrën kanë kaluar nëpërmjet përkatësisë në kampe ose grupimeve të

¹ Shih, S.P Huntington, *Përplasja e qytetërimeve*, Logos-A 2004, Përkthyer nga aglishtja, f. 21.

ndryshme, herë në dy, herë në tri e herë në më shumë. Në qoftë se në kohën e Luftës së Ftohtë, përkatësisht në vitet 60' ishin tri blloqe (bota e lirë, blloku komunist, vendet e paangazhuara). Pas viteve, 90' mund të flasim për shtatë ose tetë grupime (perëndimore, latino-amerikane, afrikane, islamike, simike, hindu, ortodokse, budiste, japoneze).² Në këtë botë të re ku shihet qartë se shoqëritë joperëndimore gjithnjë e më tepër ngulitin vlerat e tyre kulturore dhe hedhin poshtë ato të imponuara nga Perëndimi vihet re një risi që politologët e përkufizojnë duke u nisur nga dy polet e politikës së sotme botërore, politika lokale dhe globale, ose lokalizmi dhe globalizmi; le ta themi këtë me fjalët e një politologu të famshëm: "...në këtë botë të re, politika lokale është politikë e etnicitetit, politika globale është politikë e qytetërimeve. Rivaliteti ndërmjet superfuqive është zëvendësuar nga përplasja e qytetërimeve".³ Ndërkaq në hyrjen e kësaj kumtese nuk mund të mos theksojmë edhe një konkluzion interesant gjithashtu të rëndësishëm, se në botën pas Luftës së Ftohtë kultura është forcë, njëkohësisht, si ndarëse ashtu edhe bashkuese. Njerëzit e përçarë nga ideologjia, por të bashkuar prej kulturës, lidhen bashkë, ashtu siç bënë dy Gjermanitë dhe ashtu siç kanë nisur të bëjnë dy Koretë dhe disa Kinat. Shoqëritë e bashkuara nga ideologjia a nga rrethanat historike, por të përçara nga qytetërimi, ose copëtohen siç ndodhi me Bashkimin Sovjetik, Jugosllavinë e Bosnjën, ose vuajnë nga tensione të fuqishme siç është rasti në shumë vende të tjera të botës. Më së fundi, shtetet me afëri kulturore bashkëpunojnë ekonomikisht e politikisht. Organizat ndërkombëtare të mbështetura në shtetet me përbashkësi kulturore, si Bashkimi Evropian, kanë më tepër sukses sesa ato që përpiqen t'i sipërkalojnë kulturat.

Fundshekulli që u mbyll dhe fillimi i mijëvjeçarit të tretë i vunë njerëzimit përpara një prej shfaqjeve më të rëndësishme: *komunikimin global*. Përmasa e mbisundimit të komunikimeve globale nga Perëndimi është burim kryesor i pakënaqësisë së popujve joperëndimorë ndaj Perëndimit. Këtu sigurisht janë me shumë rëndësi: gjuha dhe feja e njerëzimit, si elemente qendrore të çdo qytetërimi. Ka filozofë që mendojnë se nëse po përftohet qytetërimi universal (globalist, ose gjithëbotëror) atëherë duhet të ketë prirje drejt përfuturit të një gjuhe universale dhe të një feje universale. Ky synim është shprehur shpesh lidhur me gjuhën. Le të kujtojmë ndër të tjera pohimin "Gjuha botërore është anglishtja", siç e ka shprehur redaktori i *Wall Street Journal*⁴. Kjo mund të pranohet vetëm në një kuptim, anglishtja që është gjuhë e huaj për 92% të botës nuk mund të jetë gjuhë botërore, por ajo mund të cilësohet si e tillë duke nënkuptur se ajo është gjuha e përdorur nga

² Ibidem, f, 21, harta 1,2,3.

³ Ibidem, f, 22.

⁴ Shih, Bozeman, Adda B., *Strategic Intelligence and Statecraft: Selected Essays*, Brassey's Intelligence & National Security Library, Hardcoverf, 1998, f. 26.

njerëzit e grupeve dhe e kulturave të tjera gjuhësore për të komunikuar me njëri-tjetrin, pra nëse e pranojmë anglishten si *lingua franca* e botës ose me terma të gjuhësisë si gjuha e komunikimit më të gjerë, d.m.th. si gjuha kryesore e botës. Diplomatët, biznesmenët, shkencëtarët, turistët dhe shërbimet që bëhen për ta, pilotët e linjave ajrore e kontrollorët e qarkullimit kanë nevojë për një mjet komunikimi të frytshëm me njëri-tjetrin dhe sot për këtë shërben kryesisht anglishtja, pra, në një farë mënyre jemi në atë raport që ishte latinishtja në periudhën klasike dhe mesjetare, frëngjishtja për disa shekuj në Perëndim, sëhili në shumë pjesë të Afrikës. Këtë rol të një *lingua franca* e ka marrë anglishtja në gjysmën e dytë të shek XX dhe siç po duket do të vijojë me hapa e ritme më të shpejta në mijëvjeçarin që sapo ka filluar.

Pas kësaj hyrjeje gjithsesi inkuadruese le të ndalemi në problemin kryesor të kumtesës sonë: ndikimet dhe proceset e huazimit në binomin gjuhë dhënëse – gjuhë marrëse që shkon në vijën e trajtimeve tradicionale të dygjuhësisë, por duke i shtuar këtij binomi edhe peshën ose trysninë globalizuse që shfaqet sot në të gjitha gjuhët e botës nëpërmjet bankës më të madhe gjuhësore që është ajo e anglishtes, por jo thjesht e anglishtes si gjuhë e Britanisë, por e anglishtes si gjuhë e një qytetërimi të potencuar dhe të mbështetur nga fuqia më e madhe politike dhe ekonomike e botës së sotme.

Një vështrim i shpejtë mbi ndikimet e huaja në shqipen e sotme të shkruar dhe të folur përfshirë këtu gjithë shkrimtarinë, prodhimtarinë shkrimore me karakter shtetëror, burokratik e mediatik, tregojnë se gjuha shqipe merr me dorë të lirë kryesisht nga anglishtja, por merr jo pak edhe nga gjuhë të tjera ku shquhen sidomos italishtja për sa i përket ligjëritimit gazetaresk, sportiv dhe të modës, greqishtja për hapësirat e lidhura me elementin shqiptar të besimit ortodoks të rritit grek. Në këtë kuadër mund të themi se ka pasur dhe ka vendin e vet edhe terminologjia orientale që lidhet edhe ajo me një mjedis tashmë tradicional (por edhe të përtërirë) të shqiptarëve të besimit islam, tashmë edhe të përtërirë dukshëm në kuadrin e rikthimit të fesë myslimane, e ndihmuar edhe nga intensifikimi i komunikimit me Orientin në tërësi.

Pavarësisht se sot Shqipëria, shqiptarët, dhe gjuha e tyre janë nën trysninë shumë të madhe të anglishtes si dhe të gjuhëve fqinje, veçanërisht të italishtes, vijon të jetë edhe një sasi e madhe orientalizmesh shumë prej të cilave kanë një shtrirje dhe përdorim gati gjithëpopullor. Mund të thuhet se me gjithë fushatat “purifikuese” ose gjuhëpastruese të ndërmarra në kohë të ndryshme, që nga Rilindja e këtej, gjuha shqipe nuk u çlirua kurrë prej orientalizmave, shumica e të cilave janë fjalë që emërtojnë sende të përdorimit të gjerë.

Mund të themi madje se huazimet nga turqishtja por edhe përgjithësisht orientalizmat me kohë nuk ndihen më si barbarizma por thjesht si huazime ose si fjalë që, siç thoshte prof Çabej "janë bërë tashmë mishi e ashti i shqipes"⁵. Për shembull fjalë si: *tepsi, zinxhir, bojë, raki, çarap, çarçaf, çizme, pazar, berber, kasap, bajrak, kanun, xhelat, hoxhë, dervish, synet, bori, daulle, dyfek, fitil, xhep, dyshek, jorgan*,⁶ Me fjalë të tjera edhe ky mjeshtër i madh dhe njohës aq i mirë i pasurisë dhe vlerave të shqipes, i mbante disa prej orientalizmave si të pazëvendësueshme, ose së paku si vështirësisht të zëvendësueshme.

Në mbetjen gjallë të orientalizmave duket se kanë ndikuar dy prirje të ndryshme për nga natyra, të cilat kanë shpënë tek i njëjti rezultat. Është një fakt i njohur tashmë se të paktën që pas Rilindjes, orientalizmat në përgjithësi dhe turqizmat në veçanti fituan një lloj ngjyrimi përkeqësues të cilin nuk e kishin pasur më parë. Ky ngjyrim me kalimin e kohës u dendësua aq shumë sa në më shumë se një rast e zhvendosi thuajse krejt kuptimin fillestar. Një dukuri e tillë pas të gjitha gjasave ka lindur fillimisht në meset e të shkolluarve e mandej është shtrirë edhe në përdoruesit e tjerë të gjuhës. Pikërisht falë këtij ngjyrimi e kuptimi të ri, një pjesë e huazimeve orientale mundën të mbijetonin edhe pas dublimit të tyre me fjalë të burimit veldaq. Fjalë si *qatip, defter, mehmur, pasha, bimbash, vezir, talim*, etj mundën të mos të dilnin nga përdorimi pikërisht falë atij ngjyrimi të ri përkeqësues që fituan pas mesit të shek.XIX e që vazhdojnë ta kenë edhe sot. Prirja e dytë lidhet me një tjetër rrethanë: huazimet orientale me kohë janë bërë pjesë te fondit të mbarë shqipes dhe ato nuk mund të shërbenin si element të dallimit dialektor. Ërhtë e vërtetë që në gegërishte hasim rregullimin mekanik të theksit,⁷ që prek kryesisht fjalët e burimit oriental, por kjo dukuri nuk "e rrezikon" fjalën si njësi të leksikut.

Dhe në këtë kuptim ato kanë shërbyer e shërbejnë si një faktor koheziv. Fat që nuk e kanë huazimet nga gjuhë të tjera të kohërave të reja.

Këtu e shohim me vend të bëjmë një sqarim për sa i përket rrafshit terminologjik për aq sa me me turqizma kemi kuptuar ato njësi, fjalë a shprehje frazeologjike, të cilat kanë hyrë në shqipen drejtpërdrejt nga turqishtja dhe që, mbështetur në gjendjen e studimeve të derisotme, nuk dyshohet se kanë qenë huazuar në turqishten prej ndonjë gjuhe tjetër. Sigurisht, edhe ky përcaktim a kufizim nuk është gjithsesi i "imunizuar" prej problemeve interpretative. Kjo do të thotë që edhe nëse jemi të sigurtë se aksh fjalë ka ardhur drejtpërdrejt nga gjuha turke, nuk

⁵ Shih Çabej, Egerem *Për pastërtinë e gjuhës shqipe dhe Gj. Shkurtaç Si të shkruajmë shqip*. Tiranë, Toena, 2008.

⁶ Shih Çabej, Egerem *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, Tiranë, SF 1975, No. 4.

⁷ Shih Gjinari, Jorgji dhe Shkurtaç, Gjovalin, *Dialektologjia*, Tiranë, SHBLU, 2003.

mund të jemi gjithaq të sigurtë se ajo nuk ka rrjedhur prej ndonjë entiteti tjetër gjuhësor, sepse një gjë e tillë do të kërkonte analiza etimologjike shumë më të thella se ato që mund të ofrojë një trajtesë kësodore. Po ashtu, nuk kemi ndër mend të vëmë në pikëpyetje edhe ato pak gjëra të pranuar tashmë prej studiuesve kompetentë lidhur me dallimet mes huazimeve të drejtpërdrejta e të tërthorta. Megjithatë jemi të vetëdijshëm që një problem i kësaj natyre do të na dalë përpara e që në njëfarë mase edhe fati i trajtesave të këtij lloji varet nga përgjigjja që marrin pyetje të ngjashme me ato që ne dëshirojmë t'u shmangemi jo pa qëllim qysh në krye. Le të kujtojmë se e ajo që përmbahet sot në togfjalëshin "gjuha turke" nuk ka qenë as në kohë dhe as në hapësirë një entitet i vetëm, unik e homogjen. Që këtë nuk është e vështirë të kuptohet se, edhe në raport me shqipen, ajo nuk ka qenë dhe s'mund të ishte e tillë. Po të hedhim një sy prapa në histori, shkurtimisht, kontaktet e para të shqiptarëve me islamin dhe gjurmë të islamizimit të tyre dëshmojnë relativisht herët.

Në shekujt e mesjetës paraosmane tokat shqiptare, për hir të pozitës së tyre gjeografike, janë frekuentuar mjaft dendur prej misionarëve të botës islame araboturke, qoftë për qëllime tregtare, qoftë për qëllime fetare apo ushtarake.

Në këtë drejtim, lipset thënë se islamizimi i popullsisë shqiptare si proces i tërësishëm nuk është se ndodhi ab nihilo; përkundrazi, këto kontakte të para, sado që shfaqen të kufizuara, luajtën deri diku rolin e tharmit, njëlloj siç pati ndodhur edhe me rastin e krishterimit, bogomilizmit, ikonoklastizmit etj., duke lehtësuar në mënyrë mjaft të ndjeshme masivizimin që përhapja e besimit islam njohur gjatë periudhës së pushtimit osman⁸.

Porse, ky faktor vijoi të ishte për një kohë relativisht të gjatë tejet i kufizuar, dhe kjo për shkak të asaj tolerance historikisht tashmë të mirë njohur që osmanët e hershëm treguan ndaj besimeve të tjera. Përmes pushtimeve në shkallë të gjerë, synimet e hershme të osmanëve ishin fillimisht të karakterit gjeopolitik, gjeostrategjik dhe gjeoekonomik, dhe assesi jo gjeofetar, çka e bën perandorinë osmane të fillësive krejt të dallueshme nga perandoria e Medines, për shembull, e cila e lidhte zgjerimin territorial me përhapjen e mesazhit islam. Në këtë kuptim mund të dallonim edhe brenda turqishtës një *turqishte të vjetër* dhe një *turqishte të re*⁹; sipas së njëjtës logjikë tani mbi bazën e kriterit diatopik mund të dallojmë një *turqishte të Turqisë* dhe një turqishte të të ashtuquajturave *republika turke*, si fjala vjen Azerbajxhani, Ozbekistani, Tyrkmenia etj. Afërmendsh që shqipja ka pasur marrëdhënie të ngushta, në përdorimin e saj të folur e të shkruar, me të

⁸ Inalçik, Halil. *Sureti defteri Sancaki Arvanit*. Ankara, TDK Yayinlari, 1984, f. 27.

⁹ Ercilasun, Ahmet. *Türk Dili Tarihi*. Ankara, Akçağ Yayınları, 2006. f. 437.

gjitha këto entitete, së paku gjatë periudhës së kontakteve më intensive mes “dy gjuhëve”. Për të dhënë një kufi qoftë edhe të përafërt kohor këtë pikëtakim a ndërndikim kulturor e gjuhësor do ta vendosnim mes viteve 1385 dhe 1912. Jashtë këtij kufiri, që duket deri diku arbitrar, mbetet një datë e rëndësishme për historinë e gjuhës turke të Turqisë, 1928-a, viti i reformës qemaliste¹⁰ në punë të gjuhës. Kjo datë, prej shumë gjuhëtarëve turq e të huaj mbahet edhe si “datëlindja” e turqishtes së re. Nga sa thamë, shpresojmë të jetë e qartë se termi *turqizëm* është jo pak problematik, madje ndonjëherë edhe spekulativ, për më tepër kur edhe ne u shmangemi me dashje prurjeve të tjera që janë pagëzuar me emrin e përbashkët *orientalizma*. Megjithatë, nuk është gjithmonë e lehtë t’u shmangesh orientalizmeve, aq më tepër kur je i shtrëngur që prej shqyrtimit në parim, t’i shtrohesh analizës rast pas rasti. E themi këtë ngaqë një pjesë e mirë e të ashtuquajturave orientalizma më parë se të hynin në shqipen kanë qenë pjesë e vetë turqishtes. Kjo është aq më shumë e vërtetë për një numër leksemash që në origjinë u takojnë gjuhëve të tjera, më së shumti arabishtes dhe persishtes. Pa mëtuar të bëjmë këtu etimologjinë e njësive të tilla, mjafton të themi se një numër i mirë fjalësh (emra të përgjithshëm), si : *kalem, sulltan, padishah, qitap, musliman, pejgamber, kadi, melaqe (melaiqe), shejtan, ezan, muezin, imam, mendile, vatan, kurban, insan, devlet (dovlet)*¹¹ ose emra të përveçëm, si: *Myzejen, Qerim, Ramazan, Shaban, Nazim e Nazmi, Sherif e Sheraf* etj. e shpërfaqin problemin që përmendëm më lart, ngaqë ato në thelb u takojnë gjuhëve si arabishtja e persishtja. Është e vërtetë se në shqipen ato kanë hyrë më së shumti prej turqishtes, por, gjithsesi, ky fakt nuk na duket i mjaftueshëm për t’i konsideruar thjesht turqizma.

Huazimet leksikore mund të shfaqin edhe disa forma më të ndërlikuara, siç është rasti i kalkeve, shprehimisht këtu, ndërmbartja morfemore e një fjale, e një fraze apo fjalie nga një gjuhë në tjetrën, duke ruajtur të paprekur konstruktin dhe semantikën e saj, siç shfaqet rasti i fjalës “mëmëdhe”, “fiskulturë” etj., të cilat janë përkthim morfemë për morfemë i fjalëve të turqishtes “*anevatan*” dhe “*bedenegitim*”, i shprehjeve frazeologjike dhe i fjalëve të urta si *u rrokullis tenxherja dhe gjeti kapakun, s’ke ç’i bën gomarit i bie samarit, me të pyetur gjen Stambollin*¹² etj. Krahas kësaj, huazimet mund të shfaqen edhe të natyrave të tjera

¹⁰ Kështu quhet gjithandej në Turqi reforma politike, ekonomike dhe kulturore e ndërmarrë aso kohë nga Mustafa Qemal Ataturku, i quajtur prandaj edhe “ati ose babai i Turqisë moderne”.

¹¹ Është respektuar grafia e shqipes, pavarësisht prej formës me të cilën dalin në gjuhët nga vijën.

¹² Gjatë punës me këtë kategori shprehjesh, fjalësh të urta apo proverbash, jemi përqendruar thujse gjithnjë tek hershmëria e tyre, për evidentimin e të cilës, për herë të parë në studimet shqipe, kemi përdorur dhe shfrytëzuar gjerësisht një vepër e përmasave të *Ouzname-s, Amaneti i turqve Ouzë*, e cila daton shekujt XIII-XIV.

gjuhësore, të tilla si huazimet *fonologjike*, siç ndodh në rastet kur një gjuhë përvetëson nga një tjetër disa tinguj të ri, që nuk i ka patur më parë në repertorin e vet fonetik; huazime *morfologjike*, në rastet kur një gjuhë përvetëson nga një tjetër një varg morfemash, kryesisht parashtesa apo prapashtesa, si në rastin e "burra-cak", apo "drita-re", e cila është fryt i një gërshetimi të dukurisë së *përkthimit morfematik* (turqisht *penc* – drita), nga njëra anë, dhe dukurisë së *përvetësimit morfologjik* (prapashtesa *re*), nga ana tjetër; dhe, së fundmi, huazimet në rrafshin sintaksor dhe gramatikor, të cilat janë në të njëjtën kohë edhe format më të "thella" dhe më të vështira për t'u evidentuar.

Krahas qarkësimeve dhe konceptualizimeve të mësipërme, një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe llojshmërisë së huazimeve dhe të natyrës së tyre, duke ndjekur një perspektivë të qartë të klasifikimit të tyre qoftë sipas tipologjive – nga më të thjeshtat, rastet e huazimit të drejtpërdrejtë, tek format më të ndërlikuara, rastet e huazimeve të tërthorta. Më konkretisht, nisur nga faktorët dhe tiparet e kontaktit gjuhësor që mundësoi vetë huazimin si proces; nga faktorët historikë, deri tek ata socialë, politikë, fetarë dhe kulturorë. Përpos të qenit forma më e thjeshtë e shfaqjes së huazimit si dukuri, huazimet leksikore janë më të hasura për shkak se në rastin e tyre nuk është e thënë që mes dy bashkësive të folësve të ekzistojë me patjetër një kontakt fizik¹³. Ekzistenca apo mosekzistenca e një kontakti të këtillë ndihmon jo vetëm në përcaktimin e natyrës së huazimit dhe të shkakësive që e mundësojnë, por edhe të dinamikës së tij. Për shembull, në anglisht hasim një repertor të dendur fjalësh të huazuara nga latinishtja klasike; mes anglishtfolësve dhe latinishtfolësve nuk ka ekzistuar ndonjë pikë kontakti gjuhësor i fortë dhe i dendur. Në këtë drejtim, e vetmja pikë "kontakti" kanë qenë shkrimet dhe veprat e shkruara në latinisht, çka ndihmon në përcaktimin e dinamikës së huazimeve, shprehimisht këtu, në klasifikimin e tyre për sa i përket *shkakësisë* që i mundësoi si të tilla, nëse janë huazime të natyrës poetike, filozofike, politike, fetare etj. Në këtë drejtim mund të sillnim edhe rastin e huazimeve në shqip nga arabishtja dhe persishtja; mes shqiptarëve, arabëve dhe persëve nuk kanë ekzistuar kontakte të dendura. Pohimi se të këtilla huazime janë mundësuara nga një kontakt gjuhësor jo i drejtpërdrejtë, shprehimisht nga turqishtja, shfaqet pjesërisht i vërtetë dhe i pamjaftueshëm, dhe kjo për një arsye më se të thjeshtë: dinamika që shpërfaqin huazimet arabe dhe perse në shqip është më e pasur sesa ajo që shfaqin huazimet arabe dhe perse në gjuhët turke. Kështu, për shembull, dinamika e huazimeve që turqishtja pati nga arabishtja përqendrohet thjesht dhe vetëm në një aspekt, në atë

¹³ Sapir, Edward. *Selected Writings of Edward Sapir in Language, Culture and Personality*, Berkeley, Los Angeles, London, University of California Press, 1973.

kuranik¹⁴, i cili lipset parë si i ndarë nga aspekti fetar; ndërkaq, dinamika e huazimeve që turqishtja pati nga persishtja është shumë herë më e gjerë dhe, për më tepër, përfshin në vetvete qoftë aspektin fetar, qoftë aspektin botëkuptimor, qoftë atë kulturor. Në një formë apo në tjetrën, këto dinamika u përcollën edhe në gjuhën shqipe; porse, krahas kësaj, në gjuhën shqipe gjejmë edhe dinamika të tjera, të cilat na ofrojnë një tjetër burim huazimi nga ai i turqishtes.

Kështu, për shembull, në shqip hasim fjalë arabe që nuk kanë kurrfarë burimi kuranik, të tilla si "xhirafë", "algjebër", "zero", "doganë", "admiral" etj. Të këtilla fjalë janë huazuar më tepër nga gjuhët perëndimore, përkatësisht nga italishtja e cila i përvetësoi këto të fundit në kontaktet e saj të drejtpërdrejta me arabishten përgjatë shekujve XIII - XIV¹⁵, sesa nga turqishtja. Si argument mbështetës në këtë drejtim mund të silllet aspekti fonetik; fjala "xhirafë" në turqisht është "zürafa", ndërkohë që në shqip është sipas sistemit shqiptimor dhe fonetik të italishtes; fjala "algjebër" në turqisht është "cebiri", ndërkohë që në shqip e gjejmë sipas trajtës shqiptimore që termi arabishtes "Al Gebir" njohu ndër gjuhët perëndimore. Jemi të mendimit që korpusit të orientalizmave të shqipes mund t'i shtojmë edhe një pjesë të italianizmave të cilat kanë transmetuar tërthorasi një numër të konsiderueshëm nga leksiku oriental¹⁶.

Nga leksiku ushtarak

Admiral – *Ammiraglio* – Nga arabisht *am'r* (komandant, princ, guvernator), përvetësuar nga greqishtja *amerás*.

Doganë – *Dogana* – Nga arabisht *diwan(a)*, libër ku shënohen mallrat në tranzit.

Magazinë – *Magazzino* – Nga shumësi i fjalës arabe *makhāzin*, depozitë.

Veshje dhe ngjyra

Kremis – *Cremisi* – Nga arabisht me etimologji oгуze, qirmizī "nga ngjyra e një krimbi", një variant të kësaj fjale e gjejmë edhe në persisht

Xhup – *Giubba* – Nga arabisht, *ǧubba* "veshje prej pambuku".

Artikuj shtëpiakë

Karaf – *Caraffa* – Nga arabisht *garrafa* "vazo cilindrike e punuar nga balta dhe argjila": duket e mikluar nga fjala tjetër arabe, qaraba, "shishe me grykë të gjerë".

Terasë – *Ma-terasso* – Nga arabisht matrah – taraha "hedh, shkund", d.m.th. "vend ku hidhen gjërat, ose vendosen gjërat që i përdorim më rrallë", kjo fjalë rastis të

¹⁴ Johanson, Lars. *The Turkic Languages*, London, Routledge, 1998, f. 78-81.

¹⁵ Gori, Alessandro. *Gli arabismi nell'italiano*, Nè, Istituto regionale Toscana orienti, 2011, f. 3.

¹⁶ *Ibidem*, f. 3-7.

përdoret edhe në frëngjisht, gjermanisht, anglisht. Rruga prej nga ka depërtuar mbetet italishtja.

Leksiku nga administrata

Ottomano – Otoman, varianti për fjalën osman nga turqishtja.

Peme, fruta, specie etj.

Aranciata – *Arancio* – Nga arabisht *naṛangi*, me origjinë persiane. (në italisht kemi kalimin e n-së, *un *narancio* > un *arancio*; forma *narancio* gjendet në Ariosto dhe në disa dialekte të sajë ndërsa në Venecia e gjejmë edhe në trajtën *naranza*).

Limon – *Limone* – Nga arabisht dhe persisht *limuun*.

Leksiku nga astronomia dhe matematika

Algjebër – *Algebra* – Një zë i përkthyer nga Oksidenti nga Leonardo Fibonacci në *Liber Abbaci* (1202) prej arabishtes *‘ilm al-gābr ʿa al-muqāḥala*.

Alogoritëm – *Algoritmo* – termi është derivat i vetë emrit të matematicienit *al-Khārizmi*, nga një rajon i Azisë.

Zero – *Zero* – Nga arabisht *sūfir*, bosh, me etimologji nga sanskritishtja *śūnyā*

Shifër – *Cifra* – Një kalk nga matematicieni Guido Grandi më 1740, në italisht (cioè zero) .

Nadir – *Nadir* – Nga arabisht *nazir*, (pikë).

X – X – Nga arabisht *ṣāyʿ*,

Zenit – *Zenit* – Nga arabisht *ṣamt al-ruʿus*, (drejtimi i kokës).

Leksiku I kimisë

Lambik – *Alambicco* – Nga arabisht *al-anbiq*, një derivat nga greqishtja *ámbix*.

Alkalin – *Alcali* – Nga arabisht *al-qaly*, (mbetje).

Kimia – *Alchimia* – Nga arabisht *al-kimiyaʿ*, me një etimologji greke *chyméia*.

Alkol – *Alcol* – Nga arabishtja e Spanjës *kuḥūl*.

Fusha të tjera

Meskin – *Meschino* – Nga arabisht *miskīn* me etimologji akadiane (i varfër).